

Procedurat Standarte Operacionale (PSO) janë përgatitur nga një komitet ekspertësh dhe miratuar me vendim Bordi, në të cilat janë dokumentuar të gjitha dimensionet/aspektet e punës të proceseve/procedurave që zbatohen në ofrimin e kujdesit shëndetësor në departamente të ndryshme.

Këto dokumente përfshijnë të gjitha shërbimet në Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Koço Gliozheni”.

Palët e interesuara duhet të jenë të trajnuar me protokollet standarte të procedurave dhe udhëzimet ekzistuese përkatëse teknike. Manualet e përmendura në PSO janë në dispozicion të palëve të interesuar.

Qëllimi i Procedurat Standarte Operacionale (PSO) synon të sigurojë që të gjithë pacientët në shërbime të ndryshme të ndiqen dhe tu ofrohet kujdes cilësor në një mjedis me rrezik minimal, duke mbuluar çdo aspekt të kujdesit ndaj pacientit.

Procedurat Standarte Operacionale (PSO) mbulojnë të gjitha proceset dhe udhëzimet që ndiqen nga të gjithë mjekët, infermierët dhe personeli mjekesor. Përfshihet ofrimi i shërbimeve parandaluese, diagnostikuese, kurative dhe rehabilituese.